

së në Beograd. Në muajin maj të vitit 1998, shkoi me njësitin e tij në Kosovë. Gjatë qëndrimit në Kosovë, vetëm një herë ka shkuar në shtëpi për pushime. Herën e fundit iu lajmërua familjes më 24.07.1998. Dy ditë më pas, familjes i është bërë të ditur zyrtarisht se Velibori e humbi jetën më **25.07.1998**, në fshatin **Junik**. Ai u varros në varrezat e Vranjes më 27.07.1998.

**Burimet:** deklarata S.S, FDH-25050; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 66,67; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110; SMIP, *Teroristički...*, III, 935.

### **Vezir (Hysen) Ademaj**

(15.03.1971, shqiptar nga Sheremeti/Šeremet, komuna e Gjakovës/Đakovica, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Vezi jetonte në fshatin Sheremet/Šeremet. Në bashkësi familjare me të ishin prindërit, vëllai i madhe me familje, si dhe familja e vëllait të dytë, i cili punonte në Zvicër. Ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Në datën **25.07.1998**, menjëherë pas orës 7:00, kanë ardhur dy pjesëtarë të UÇK-së dhe e kanë ftuar Vezirin për tu ndihmuar në mbrojtjen e fshatit. Po atë ditë [25.07.1998], Vezi ra në betejë me forcat serbe që u zhvillua në lagjen *Kallavaj*. E varrosën po atë ditë në varrezat e fshatit të lindjes në Sheremet/Šeremet.

**Burimet:** deklarata M.A, FDH-31933; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### **Ramiz (Januz) Gashi**

(25.02.1971, shqiptar nga Sverka/Svrh, komuna e Klinës/Klina, punëtor ndërtimor, pjesëtar i UÇK-së)

Ramizi me bashkëluftëtarë u nisën për në Shqipëri në fillim të verës së vitit 1998. Në datën **27.07.1998**, familja ka dëgjuar në lajmet e *Radio-Televizionit të Prishtinës* se, po atë ditë, Ramizi ka pësuar në fshatin **Gjocaj/Đocaj**, në afërsi të kufirit me Shqipërinë. Pas përfundimit të luftës, i vëllai Bajrami ka mësuar nga drejtori i ndërmarrjes *Çabrat/Čabrat* se Ramizin e patën varrosur në varrezat e fshatit Bërkoc/Brekovac [Gjakovë/Đakovica].

Më 9.10.2000, është kryer zhvarrimi i këtij lokaliteti. Pas identifikimit të mbetjeve të tij mortore po atë ditë, Ramizin e varrosën me ushtarë të tjerë të vranë të UÇK-së nga territori i komunës së Klinës/Klina, në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica.

**Burimet:** deklarata B.G, FDH-30707; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### **Avdyl (Ali) Jasiqi**

(26.03.1966, shqiptar nga Jasiqi/Jasić, komuna e Deçanit/Deçani, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Avdyli me familje jetonte në Jasiqi/Jasić. Në fund të muajit mars të vitit 1998, aderoi në UÇK. Mori pjesë në luftimet me forcat serbe që janë zhvilluar nga marsi deri në korrik të vitit 1998, në rajonet e fshatrave Junik dhe Jasiqi/Jasić. Në datën **28.07.1998**, duke u kthyer në bazë nga një aksion, Avdylli hyri në një fushë të minuar nga forcat serbe, në vendin e quajtur *Zhare/Žare* [fshati **Gjocaj/Đocaj**]. Gjetei vdekjen në vend.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; *Lista e dëshmoreve të brigadës 138 Agim Ramadani*, www.kosharja99.info, FDH-19099.

### **Musë (Ali) Ganija**

(25.05.1943, shqiptar nga fshati Gjocaj/Đocaj, komuna e Deçanit/Deçani, punëtor ndërtimor, tetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Musa u bë pjesëtar i UÇK-së më 28.03.1998. godine. Kishte për detyrë që të mbante rojë në lagjen e tij *Ganijaj*. Në datën **28.07.1998**, ai gjendej në pozicionin e vet luftarak, kur filluan përleshjet mes UÇK-së dhe forcave serbe në fshatin **Gjocaj/Đocaj**. Një predhë ka rënë në afërsi të tij duke e qëlluar për vdekje. Në mbrëmje, pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati, familjarët dhe pjesëtarët e UÇK-së e varrosën Musën në një fushë në afërsi të shtëpisë së tij. Pas përfundimit të konflikteve, ai u shpall dëshmor i luftës. Musa prehet edhe sot në vendin ku u varros gjatë luftës.

**Burimet:** deklarata I.G, FDH-29573; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.